

03-374

30.11.2016



Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS
VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA



Inspektorati Policor i Kosovës
Policijski Inspektorat Kosova
Police Inspectorate of Kosovo

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Raporti i Inspektimit Nr: 7 /2016

INSPEKTIMI NË QENDRAT E NDALIMIT NË POLICINË E KOSOVËS



HILMI MEHMETI

Kryeshef Ekzekutiv i IPK- së

Hilmi Mehmeti



SHKURTESAT

IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
PK	Policia e Kosovës
DI	Departamenti i Inspektimeve
DRP	Drejtoria Rajonale e Policisë
DSP	Divizioni për Siguri Publike
DKMK	Divizioni i Kontrollit dhe Mbikëqyrjes së Kufirit
DPVO	Drejtoria për Planifikim dhe Vlerësim Operacional
DSHM	Departamenti për Shërbime Mbështetëse
SP	Stacionet Policore
SPK	Stacionet Policore Kufitare
QN	Qendrat e Ndalimit
KPPK	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës
PSO	Procedurat Standarde të Operimit

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	(4-5)
2. HYRJE	(6-7)
3. PËRMBLEDHJE E TË GJETURAVE	(8-19)
3.1 Identifikimi dhe vlerësimi i procedurave në Qendrat e Ndalimit;	
3.2 Identifikimi dhe vlerësimi i kushteve materiale në Qendrat e Ndalimit;	
3.3 Identifikimi dhe vlerësimi i aspektit të sigurisë në Qendrat e Ndalimit;	
3.4 Vlerësimi i implementimit të rekomandimeve të IPK-së lidhur me Qendrat e Ndalimit.	
4. PËRFUNDIMET	(20-22)
5. REKOMANDIMET	(22)
6. PLANI I VEPRIMIT I PK-së PËR PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE TË IPK-së.....	(23-24)

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1.1 Qendrat e ndalimit (QN) janë hapësira në të cilat vendosen personat e arrestuar për dyshime të bazuara se mund të kenë kryer ndonjë vepër penale. Ndalimi policor bëhet me urdhër të organeve kompetente të përcaktuara sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe nuk mund të kalojë afatin e përcaktuar kohor prej dyzet e tetë (48) orësh. Këto qendra të ndalimit ndodhen në objektet policore që administrohen dhe menaxhohen nga zyrtarët policor sipas akteve ligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe në pajtueshmëri me normat ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të personave që ndalohen në këto qendra.

1.2 Me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së është zhvilluar inspektimi i rregullt, në QN të Policisë së Kosovës. Objektivet që janë synuar të arrihen përmes këtij inspektimi ishin: Identifikimi dhe vlerësimi i procedurave në Qendrat e Ndalimit; Identifikimi dhe vlerësimi i aspektit të sigurisë në Qendrat e Ndalimit; Identifikimi dhe vlerësimi i kushteve materiale në Qendrat e Ndalimit; Vlerësimi i implementimit të rekomandimeve të IPK-së lidhur me Qendrat e Ndalimit.

1.3 Gjatë zhvillimit të inspektimit në terren janë përdorur disa teknika të ndryshme të mbledhjes së të dhënave si: vizita në terren, intervista me zyrtarët përgjegjës për menaxhimin me qendrat e ndalimit, fotografimi i qendrave të ndalimit si dhe marrje dhe analizim i dokumenteve të tjera relevante PK-së lidhur me këto qendra. Inspektimi ka përfshi verifikimin e të dhënave dhe kushteve materiale të sigurisë për periudhën kohore 01.01.2015 deri më 31.12.2015, si dhe gjendja momentale gjatë inspektimit në QN në PK. Inspektimi është realizuar në tridhjetë e një (31) qendra të ndalimit por të gjeturat në këtë inspektim janë pasqyruar në pesëmbëdhjetë (15) QN për shkak se disa tjera kanë qenë në proces të renovimit si: Prishtinë, Drenas, Podujevë, Lipjan, Suharekë, Gjilan, Kamenicë, Viti, Gjakovë, Klinë dhe Ferizaj, kurse disa tjera kanë qenë jashtë funksionit për arsye të ndryshme (Skenderaj; Mitrovicë Veri; Kaçanik dhe Lluzhan). kanë qenë proces të renovimit.

1.4 Të gjeturat kanë treguar se Policia e Kosovës (PK) me qëllim të respektimit të drejtave të njeriut dhe trajtimit të tyre në mënyrë sa më humane, ka nxjerrë Procedurë Standarde të Operimit (PSO) nr. referues DDO-04/022/2013, me anë të së cilës është rregulluar funksionimi i QN-ve. Kjo PSO përmban dhe përmbush në vijë të përgjithshme kriteret e kërkuara me qëllim të kryerjes së punëve, detyrave dhe përgjegjësive të zyrtarëve policor në QN, si rrjedhojë e së cilës është rekomanduar që DPVO të angazhohet në drejtim të azhurnimit të kësaj PSO-je, me qëllim të precizimeve më detaje rreth procedurave të pranimi-kontrollimit të personave të ndaluar apo përcaktime rreth emërimit të dispozitave ligjore dhe akteve tjera normative të cilat parashohin detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve policor në QN.

1.5 Inspektimi ka vënë në pah se totali i hapësirës së dhomave të ndalimit të cilat kanë qenë në funksion në bazë të matjeve që iu është bërë gjatë inspektimit, është 507,5 m², nga ku del se të gjitha qendrat e ndalimit nga DSP e plotësojnë kriterin e paraparë të PSO-së për rreth shtatë (7) m² si hapësirë e dëshirueshme, kurse nga DKMK është gjetur se qendrat e ndalimit në pikat kufitare kanë më pak metra katror sesa është e përcaktuar, por gjithnjë duke potencuar se këto qendra nuk i mbajnë të ndaluarit aty për kohë të gjatë sepse me procedurë të shpejtë personat e arrestuar/ndaluar dorëzohen në QN që janë në DSP.

1.6 Lidhur me kushtet materiale, inspektimi ka identifikuar dy (2) QN, me ndriçim natyral të dobët, ndërsa tek ndriçimi artificial vetëm një (1) QN-it nuk ka pasur në funksion poqët elektrik. Ventilimi ka funksionuar në trembëdhjetë (13) QN, kurse në dy (2) nga to nuk ka funksionuar. Karrige apo ulëse të fiksuara nuk ka poseduar asnjë QN, deri sa stacioni policor Laposaviq nuk ka qenë i pajisur me sirtarë për vendosjen e gjësendeve me vlerë të personave të ndaluar. Kurse si rezultat i skadimit të kontratave për mirëmbajtje të higjienës katër QN janë gjetur në kushte jo të kënaqshme higjienike. Andaj, është rekomanduar që DSHM dhe menaxherët e lartë përgjegjës për QN të intensifikojnë bashkëpunimin me qëllim të përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në PSO.

1.7 Sa i përket kushteve të sigurisë inspektimi ka treguar se nga pesëmbëdhjetë (15) QN, në gjashtë (6) nga to janë funksionale kamerat e sigurisë, dy (2) prej tyre nuk e kanë në funksion këtë kontroll, kurse shtatë (7) nga to nuk kanë fare të vendosur sistemin e kamerave. Sistemi i thirrjes përmes së cilit sinjalizohet zyrtari policor për nevojat e personit të ndaluar vetëm SPK Qafë Prush e ka në funksion këtë sistem, kurse njëmbëdhjetë (11) QN nuk a kanë të instaluar dhe tri (3) nga to e kanë jashtë funksionit këtë sistem. Aparati për fikjen e zjarrit në trembëdhjetë (13) QN ka qenë i vendosur në afërsi dhe vend të dukshëm kurse në dy (2) të tjerat nuk ka rezultuar të jetë i vendosura në një vend të dukshëm, gjersa nga ky numër i përgjithshëm në dy QN aparatet për fikjen e zjarrit ju kishte skaduar afati i përdorimit. Gjatë inspektimit dhjetë (10) QN kanë poseduar kutitë e ndihmës së parë, deri sa në pesë (5) QN nuk janë gjetur këto kuti, si dhe QN Deçan gjatë inspektimit nuk ka prezantuar planin e evakuimit.

1.8 Të gjeturat kanë treguar se dyert e dhomave në QN janë të ndërtuara nga materiali i fortë (metal) ku në pjesën e sipërme të derës është hapësira përmes së cilës bëhet komunikimi në mes personit të ndaluar dhe zyrtarit policor. Dritaret edhe pse nuk kanë standarde sa i përket dimensioneve ato ofrojnë siguri, përveç që QN në stacionin policor Istog grilat i ka të vendosura shumë afër dritareve gjë e cila paraqet rrezik për thyerje dhe personat e ndaluar mund të lëndohen. Ndërsa QN Gllloboqicë nuk ka treguar siguri tek bateria e ujit të lavamanit. Ndërsa ruajtjes- sistemimit të dosjeve në një vend të dytë në QN në DSP nuk bëhet në tri (3) QN dhe atë në Mitrovicë Jugu, Prizren dhe Laposaviq, duke përjashtuar QN në SPK për shkak se personat e ndaluar në këto qendra për një periudhë shumë të shkurtë dorëzohen në QN në DSP. Kështu që si rezultat i këtyre të gjeturave është rekomanduar që në afate sa më të shkurta kohore të vihen në funksion pajisjet për të cilat QN janë identifikuar se nuk i posedojnë apo i kanë jashtë funksionit.

1.9 Policia e Kosovës ka treguar angazhim në drejtim të implementimit të rekomandimeve që kanë dal nga inspektimi i IPK-së, të cilat për shkak të implikimeve buxhetore dhe procedurave tjera ka arritur pjesërisht ti implementojë, gjersa akoma nuk është zbatuar rekomandimi për ruajtjen dhe sistemimin e dosjeve në një vend të dytë edhe për kundër faktit se ky rekomandim nuk ka pasur implikime buxhetore.

1.10 Mbi të gjeturat e paraqitura në këtë Raport, më 18.11.2016, IPK-ja ka realizuar takim përmbyllës me menaxhmentin e PK-së, fushëveprimi i të cilit lidhet me fushën e inspektuar. Janë diskutuar detajet e raportit dhe më pas palët janë pajtuar me të gjeturat e inspektimit.

2. HYRJE

2.1 Bazuar në Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK) dhe me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së është zhvilluar inspektimi i rregullt, në Qendrat e Ndalimit në Policinë e Kosovës. Ky inspektim i funksionalizuar nga Departamenti i Inspektimit është zhvilluar nga data 08 Gusht 2016 deri më 20 Shtator 2016. Gjatë Inspektimit janë vizituar: Stacionet Policore në kuadër të Divizionit të Sigurisë Publike dhe Stacionet Policore Kufitare në kuadër të Divizionit të Kontrollit dhe Mbikëqyrjes së Kufirit.

2.2 Qëllimi i organizimit të inspektimit ka qenë:

- ✓ Të vë në pah problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen Qendrat e Ndalimit në Policinë e Kosovës.
- ✓ Përmirësimin e kushteve materiale dhe atyre të sigurisë, ngritjen e standardeve të përcaktuara me aktet ligjore pozitive, si dhe forcimin e menaxhimit dhe organizimit të punës në Qendrat e Ndalimit, që do të ndikonte dukshëm në ngritjen e nivelit të performancës në PK.
- ✓ Vërtetimin se PK-ja ka bërë ofrimin e kushteve themelore ligjore dhe materiale në drejtim të përmbushjes së detyrave drejt respektimit të lirive dhe të drejtave të personave të ndaluar, përmes së cilave do të sigurohej një shkallë më e lartë e përgjegjësisë dhe besueshmërisë në mbrojtjen dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të personave të ndaluar në këto qendra.
- ✓ Të jepet vlerësim objektiv lidhur me respektimin e dispozitave ligjore, procedurave të përcaktuara për mbarëvajtjen e punëve në këto qendra si dhe mënyrën e kryerjes së detyrave nga personeli kompetent i angazhuar në menaxhimin e Qendrave të Ndalimit në Policinë e Kosovës.
- ✓ Vlerësimin e respektimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut në përputhje me aktet normative në Kosovë dhe Konventat Ndërkombëtare për mbrojtjen dhe respektimin e të Drejtave të Njeriut për personat që ndalohen dhe mbahen në këto qendra.

2.3 Objektivet që janë synuar të arrihen përmes këtij inspektimi ishin:

- Identifikimi dhe vlerësimi i procedurave në Qendrat e Ndalimit;
- Identifikimi dhe vlerësimi i kushteve materiale në Qendrat e Ndalimit;
- Identifikimi dhe vlerësimi i aspektit të sigurisë në Qendrat e Ndalimit;
- Vlerësimi i implementimit të rekomandimeve të IPK-së lidhur me Qendrat e Ndalimit.

2.4 Si kriter matës Inspektorati Policor i Kosovës ka marrë:

- Ligji i Policisë së Kosovës;
- Procedurën Standarde të Operimit (DDO-04/022/2013)
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës etj.

2.5 Ky inspektim është përqendruar në këto drejtime:

- Respektimi i procedurave në Qendrat e Ndalimit,
- Vlerësimi i respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të personave të ndaluar,
- Vlerësimi i nivelit të sigurisë në Qendrat e Ndalimit,
- Vlerësimi i kushteve materiale në Qendrat e Ndalimit,
- Identifikimi i pengesave drejtë përmbushjes së detyrave policore nga personeli i PK-së në Qendrat e Ndalimit.

2.6 Metodologjia e punës dhe periudha e mbulimit: Gjatë zhvillimit të inspektimit në terren janë përdorur disa teknika të mbledhjes së të dhënave: vizita në terren, intervista me zyrtarët përgjegjës për menaxhimin me qendrat e ndalimit, fotografimi i qendrave të ndalimit si dhe marrje dhe analizim i dokumenteve të tjera relevante PK-së lidhur me këto qendra. Fokusi i inspektimit ka përfshi verifikimin e të dhënave dhe kushteve materiale të sigurisë për periudhën kohore 01.01.2015 deri më 31.12.2015, si dhe gjendja momentale gjatë inspektimit në Qendrat e Ndalimit në Policinë e Kosovës.

2.7 Nga viti 2005 PK-ja është angazhuar me qëllim përmirësimin e kushteve të QN-ve i cili angazhim është përfshirë në disa faza. Faza¹ e parë 2005/2006 e cila njihet si fazë e rehabilitimit të qendrave të vjetra me renovimin e tyre. Faza e dytë 2006/2007, si fazë e adaptimit të qendrave brenda hapësirave të objekteve policore ku ka qenë e mundur ndarja dhe adaptimi i tyre. Faza e tretë 2007/2009 ku njihet si fazë e ndërtimit të qendrave të reja të ndalimit, si konstruktive të reja kryesisht anekse jashtë stacioneve policore. Fazë tjetër e renovimit është zhvilluar gjatë vitit 2016² me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe ngritjes së nivelit të sigurisë në disa stacione policore ku është vlerësuar e nevojshme. Si rezultat i procesit të renovimit dhe ndërtimit të këtyre qendrave gjendja dukshëm është përmirësuar në krahasim me vitet e mëparshme në kohën kur janë ndërmarrë inspektive në këtë fushë. Andaj, ky përmirësim i gjendjes fizike të këtyre objekteve do të ndikojë për të mirë në mënyrën e kryerjes së detyrave nga personeli policor³.

2.8 Plani i aprovuar për inspektim është realizuar plotësisht në pesëmbëdhjetë (15) QN, ku prej tyre dhjetë (10) QN i takojnë DSP-së, kurse pesë (5) prej tyre DKMK-së të cilat kanë qenë në funksion në kohën kur është zhvilluar inspektimi. Vlen të theksohet që njëmbëdhjetë (11) qendra tjera të ndalimit që ka në dispozicion PK-ja kanë qenë të përfshira në proces të renovimit si: Prishtinë, Drenas, Podujevë, Lipjan, Suharekë, Gjilan, Kamenicë, Viti, Gjakovë, Klinë dhe Ferizaj, kurse katër (4) qendra të ndalimit kanë qenë jashtë funksionit për arsye të ndryshme (Skenderaj; Mitrovicë Veri; Kaçanik dhe Lluzhan).

¹ "Vlerësimi i kushteve materiale dhe aspektit të sigurisë në qendrat e mbajtjes në PK" Raporti i inspektimit nr.: 4/2013

² Kontrata për renovimin e qendrave të ndalimit në SP: Prishtinë, Glogoc, Podujevë, Lipjan, Suharekë, Gjilan, Kamenicë, Viti, Gjakovë, Klinë dhe Ferizaj. Nr. prokurimit: PK-214/16/045/521

3. PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE

3.1 Identifikimi dhe vlerësimi i procedurave të Qendrave të Ndalimit

3.1.1 Me qëllim të respektimit të drejtave të njeriut dhe trajtimit të tyre në mënyrë sa më humane Policia e Kosovës, ka nxjerrë Procedurë Standarde të Operimit (PSO) me anë të së cilës është rregulluar funksionimi i Qendrave të Ndalimit. Kjo PSO që rregullon funksionimin e këtyre qendrave disa herë është plotësuar dhe azhurnuar me qëllim që të rregulloj sa më mirë çështjen e funksionimit të tyre. Azhurnimi i fundit është bërë me datën 26.02.2013 me numër referues DDO-04/022/2013.

3.1.2 Bazë referuese në hartimin e PSO-së, Policia e Kosovës ka paraparë: Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut 1948, Konventë Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut 1953, Konventën kundër torturës dhe trajtimit të ashpër ç'njerëzor ose nënçmues 1987, Kodin e sjelljes për zbatuesit zyrtarë të ligjit 1979, Deklaratën për Policinë e Rezolutës nr. 690 (1979) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Tërësinë e parimeve për mbrojtjen e të gjithë personave gjatë paraburgimit dhe burgimit 1988, Kodin e Procedurës Penale të Kosovës 2013, Ligjin për Policinë 2012, Parimet dhe Procedurat e Policisë së Kosovës, dhe Udhëzimet Administrative.

3.1.3 Njësia përpiluese e kësaj PSO-je, ishte Drejtoria për Planifikim dhe Vlerësim Operacional konkretisht sektori për planifikim operacional. Kjo PSO në hyrje të saj i ka kushtuar rëndësi të veçantë respektimit fizik dhe mendorë të qenieve njerëzore si një nga aspektet themelore të mbrojtjes së të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, trajtim të drejtë ndaj qasjes së personave të privuar nga liria me qëllim të përbushjes së kërkesave nga konventat e ndryshme ndërkombëtare.

3.1.4 Qëllimin e hartimit të këtij dokumenti fizik PK e ka mbështetur në përcaktimin e rregullave dhe procedurave policore të cilat do të jenë konform dispozitave dhe akteve normative për mbrojtjen dhe respektimin e të Drejtave të Njeriut respektivisht të personave që ndalohen dhe mbahen në qendrat e ndalimit. Ndërsa, si fushëveprim të saj PSO-ja ka potencuar mënyrën e procedimit të formave të unifikuara dhe formularët shoqërues, kushtet e ambientit dhe akomodimin e personave të privuar nga liria.

3.1.5 Pjesa procedurale e PSO-së, ka përfshi procedurat e nevojshme me rastin e trajtimit dhe administrimit të cilat i ka ndarë në: pranim, kontrollim, evidentim, sigurim të dosjeve/gjësëndeve, akomodim/dhomave të mbajtjes, sigurinë, të drejtat, trajtimin dhe kohën e ndalimit-qëndrimit të personave të privuar nga liria në këto qendrat⁴.

3.1.6 PSO, ka potencuar se mbajtja (pranimi), kontrollimi si dhe evidentimi i personave të privuar nga liria në qendrat e ndalimit të bëhet në rastet kur kjo gjë kërkohet nga organet e rendit/sigurisë gjithnjë gjer në masën kur qendrat plotësojnë paraprakisht standardet minimale për një gjë të tillë, si dhe me qëllim të sigurimit të një mënyre standarde të procedimit të mëtutjeshëm⁵.

3.1.7 PSO-ja për qendrat e ndalimit, ka përcaktuar çështjen e mbajtjes së dosjeve për personat e ndaluar në të cilën është kujdesur që ruajtja e tyre të bëhet në dy vende, për arsye të sigurisë së

⁴ PSO-Qendrat e ndalimit, nr. referues: DDO-04/022/2013, pika D- paragrafi 1

⁵ PSO-Qendrat e ndalimit, nr. referues: DDO-04/022/2013, pika D- paragrafi 1 pika 1.1

tyre dhe mënjanimit të mundësisë së dëmtimit nga shkaqe natyrore ose faktori njeri. Sa i përket dhomave në qendrat e ndalimit procedura ka përfshi që madhësitë e tyre të jenë të arsyeshme, varësisht prej numrit të personave të vendosur në të, duke pasur ndriçim adekuat dhe të mjaftueshëm (natyral dhe elektrik), ventilim të bollshëm, dyshek, mbulesa të pastërta, orendi për pushim (p.sh. ulëse ose ulëse të fiksuara). Kjo PSO, përmasën e hapësirës së arsyeshme të ambientit ku duhet vendosur personat e ndaluar e ka bazuara në raportin e Komisionit për Parandalimin e Torturës sipas së cilës niveli i dëshirueshëm i hapësirës është caktuar të jetë rreth 7m², distanca ndërmjet mureve të jetë dy (2) ose më shumë metra, ndërsa distanca ndërmjet dyshemesë dhe tavanit të jetë dy metra e gjysmë (2.5)⁶.

3.1.8 Për shkaqe sigurie në këto qendra është paraparë që të kenë të vendosur aparatin kundër zjarrit dhe kutinë e ndihmës së parë, të nevojshme për ofrimin e ndihmës personave në raste emergjente. Po ashtu, brenda hapësirë së qendrës së ndalimit është caktuar që brenda mundësive të instalohet ndonjë sistem i përshtatshëm komunikimi me qëllim të lehtësimit të komunikimit ndërmjet të ndaluarit dhe zyrtarit policor në detyrë. Sa i përket ruajtjes së privatësisë së personave të ndaluar PSO-ja ka parapa QN të jenë të pajisura me banjo për larje dhe tualete të cilat duhet të ofrojnë pastërti dhe privatësi. Të ndaluarve është potencuar se duhet t'u ofrohet ushqim tri herë në ditë, duke përfshirë së paku një racion të plotë (diçka më të plotë se një sandviç) çdo ditë. Për shpjegime të mëtejme bazuar në KPPK, PK-ja ka përfshi në PSO edhe rregullat e përcaktuara në KPPK sa i përket 8 orëve të pushimit pa ndërprerje për periudhën 24 orësh, 2 orëve lëvizje në ambient të hapur, si dhe afatin e ndalimit policor prej 48 orë, nga koha e arrestimit të personit të dyshimtë, përveç rasteve kur gjyqtari i procedurës paraprake ka urdhëruar ndryshe⁷.

3.1.9 PSO-ja ka parapa detyrat dhe përgjegjësit e PK-së, konkretisht të DRP-ve dhe SP-ve të cilat posedojnë qendra të ndalimit, që në përgjithësi të parashohin çështjen e shpërndarjes së personelit të PK-së varësisht nga nevojat, kapacitetet dhe numri i të ndaluarve, përgjegjësinë e zyrtarëve policor lidhur me aktivitetet, veprimet dhe mosveprimet që duhet me u ndërmarrë gjithnjë sipas hierarkisë së bazuar në strukturën e aprovuar.⁸

3.1.10 Ndërsa në aneksin e kësaj PSO-je është paraparë libër-regjistrimi i cili do të duhej të shërbejë për futjen e të dhënave të të ndaluarve, i formatit A3 "Libër për Evidentimin e Personave të Ndaluar (pranuar) në Qendrën e Ndalimit", me të cilin janë vënë në përgjegjësi DRP-të që të sigurojnë/shtypin këtë libër. Bashkangjitur me PSO është përfshi Shtojca e cila ka format/formularët e standardizuar/unik (15-forma) të radhitura nga A deri në O, ku nga 15 prej tyre, 2 nga to (N dhe O) lëshohen nga Prokurori i Shtetit.⁹

3.1.11 Në kuptim të formularëve të standardizuar, IPK-së ka kontrolluar (94) dosje të arrestim/ndalimit, nga të cilat (90) prej tyre kanë përmbajt aktvendimin mbi ndalimin e personit të arrestuar nga organet kompetente kurse (4) dosje nuk kanë përmbajtë aktvendim të tillë. Sa i përket formularit për trajtim mjekësor nga 94 dosje të kontrolluara 52 persona të arrestuar/ndaluar kanë refuzuar trajtimin mjekësor, gjersa si analizimi në 42 dosjet tjera asnjë trajtim mjekësor nuk është kërkuar si shkak i ndonjë tejkalimi të forcës gjatë arrestimit nga ana e zyrtarëve policor. Mirëpo vlen të theksohet që PK ka ndërmarrë veprime procedurale dhe ndaj

⁶ PSO-Qendrat e ndalimit, nr. referues: DDO-04/022/2013, pika D- paragrafi 1 pika 1.5

⁷ PSO-Qendrat e ndalimit, nr. referues: DDO-04/022/2013, pika D- paragrafi 1 pika 1.5, 1.7, 1.9, 20,21,22.

⁸ PSO-Qendrat e ndalimit, nr. referues: DDO-04/022/2013, pika E- paragrafi 1 dhe 3

⁹ PSO-Qendrat e ndalimit, nr. referues: DDO-04/022/2013, pika E- paragrafi 5

një zyrtari policor për neglizhencë ka hapur rast disiplinor për mosndërmarrje të masave të duhura gjatë kryerjes së detyrës në qendrat e ndalimit.

3.1.12 IPK-ja, ka identifikuar dhe vlerësuar se Policia e Kosovës ka nxjerrë (PSO DDO-04/022/2013) dokument i cili përmban dhe përmbush në vijë të përgjithshme kriteret e kërkuara me qëllim të kryerjes së punëve, detyrave dhe përgjegjësive në qendrat e ndalimit, përmes së cilit dokument zyrtarët policor administrojnë dhe procedojnë veprimet me rastin e sjelljes me personat e ndaluar apo arrestuar. Po ashtu, ky dokument ka potencuar se detyrat e zyrtarëve policor në këto qendra përcaktohen me dispozita ligjore dhe akte tjera normative vendore dhe ndërkombëtare, por që nuk ka ndonjë shënim se për cilat dokumente bëhet fjalë.

3.2 Identifikimi dhe vlerësimi i kushteve materiale të Qendrave të Ndalimit

3.2.1 Mbatja e personave të ndaluar në QN duhet të bëhet çdo herë kur kjo kërkohet nga organet e rendit dhe sigurisë, me kusht që këto qendra t'i plotësojnë paraprakisht standardet minimale për një gjë të tillë. Akomodimi i personave të ndaluar në qendrat e ndalimit duhet të jetë në përputhshmëri me ligjet e aplikueshme në Kosovë dhe në pajtueshmëri me normat ndërkombëtare. Gjatë zhvillimit të inspektimit në qendrat e ndalimi është bërë vlerësimi i kushteve materiale siç është: ndriçimi natyral, ndriçim artificial, ventilimi, tualetet, pastërtia, ngrohja etj., të cilat pasqyrohen në tabelën nr. 1.

3.2.2 Në inspektim janë përfshirë të gjitha drejtoritë rajonale dhe stacionet policore të cilat posedojnë qendrat e ndalimit, mirëpo, në pesëmbëdhjete (15) qendra të ndalimit që në momentin e inspektimit kanë qenë në funksion është llogaritur numri i dhomave të ndalimit dhe kapaciteti (shtretërit) i tyre me qëllim të konstatimit nëse standardi i paraparë për hapësirë dhe standardet e tjera të lartcekura janë të plotësuara. Gjatë inspektimit janë vizituar tridhjetenjë (31) qendra të ndalimit, ku njëzet e katër (24) prej tyre i takojnë DSP-së dhe shtatë (7) DKMK-së. Për shkak të renovimit vlerësimi i standardeve të kërkuara është bërë në pesëmbëdhjetë (15) qendra të ndalimit.

3.2.3 Gjatë inspektimit janë vizituar dyzet e shtatë (47) dhoma të ndalimit në kuadër të PK-së, ku nga dyzet e shtatë (47) dhoma të ndalimit, dyzet e pesë (45) janë në përdorim (funktionale), ndërsa dy (2) prej dyzet e shtatë (47) dhomave të ndalimit të inspektuara, nuk janë në përdorim (një në Mitrovicë Jugë dhe një në Rahovec). Totali i hapësirës së dhomave të ndalimit të cilat kanë qenë në funksion në të dy departamentet e lartpërmendura, në bazë të matjeve që iu është bërë gjatë inspektimit, është 507,5 m². Kapaciteti i shtretërve në kohën e inspektimit në PK ka qenë gjashtëdhjetë e tetë (68) shtretër. Në bazë të të dhënave del se të gjitha qendrat e ndalimit nga Divizioni për Siguri Publike e plotësojnë kriterin e paraparë të PSO-së për rreth shtatë (7) m². Kurse, nga Divizioni për Kontroll dhe Mbikëqyrje të Kufijve është gjetur se qendrat e ndalimit në pikat kufitare kanë më pak metra katror sesa është e përcaktuar. (Tab. nr. 1)

3.2.4 Qelitë duhet të ofrojnë hapësirë të mjaftueshme për personat e ndaluar ku ata mund të akomodohen, duke pasur ndriçim të mjaftueshëm natyral, artificial dhe ajrim . Po ashtu, qelitë duhet të jenë të pajisura me ngrohje. Mjetet sanitare duhet t'u mundësojnë personave të ndaluar kryerjen e nevojave personale në kushte të pastra dhe të përshtatshme. Është e dëshirueshme të ketë ujë brenda qelisë dhe që të ndaluarit të kenë qasje të duhur në hapësirat e banjës dhe në të

njëjtën kohë të kenë të ruajtur privatësinë e tyre duke siguruar ngritjen e mureve ndarëse pranë tualetit.¹⁰

3.2.5 Gjatë vlerësimit të ndriçimit natyral brenda dhomave të ndalimit janë përdorur si kriter matës tri kategori të vlerësimit: dobët, mirë dhe shumë mirë. Ndriçimi natyror është vlerësuar me kriterin dobët në dy (2) qendra të ndalimit, me kriterin e vlerësimit mirë janë vlerësuar gjashtë (6) qendra, dhe me kriterin e vlerësimit shumë mirë janë gjetur shtatë (7) qendra të ndalimit. Me ndriçim të dobët natyral është vlerësuar QN Deçan dhe në SPK Hani i Elezit¹¹.

3.2.6 Ndriçimi artificial është funksional pothuajse në të gjitha qendrat e ndalimit, duke përjashtuar QN në Stacionin Policor Mitrovicë Jugu ku është gjetur se ndriçimi artificial është pjesërisht funksional, pasi që disa poqa elektrik që mundësojnë ndriçimin gjatë natës dhe gjatë ditës në hapësirat ku nuk depërton mjaftueshëm ndriçimi natyral, në momentin e inspektimit nuk kanë qenë në funksion.

3.2.7 Ventilimi është procesi i "ndryshimit" ose i zëvendësimit të ajrit në hapësirë për të siguruar cilësi të lartë të ajrit të brendshëm si p.sh. kontrollimin e temperaturës, eliminimin e lagështisë, aromave, të nxehtëit, pluhurit etj. Në kuadër të ndërtimit dhe rindërtimit të qendrave të ndalimit është integruar edhe sistemi i ventilimit i cili siguron cilësi të ajrit si dhe ndihmon shumë sidomos në rastet kur nuk ka ndriçim natyror. Gjatë inspektimit kemi gjetur se ventilimi është funksional në trembëdhjetë (13) qendra të ndalimit kurse nuk është funksional në dy (2) qendra. Ventilimi është jashtë funksionit në QN Deçan dhe QN në SPK Hani i Elezit.

Ngrohja nëpër qendrat e ndalimit është e instaluar në të njëjtën mënyrë, pra është duke funksionuar nën dyshe. Gjatë inspektimit zyrtarët policor kanë pohuar se ngrohja është shumë e mirë dhe funksionon nëpër të gjitha qendrat e ndalimit.

3.2.8 Tuelalet nëpër disa qendra është i vendosur brenda dhomës së ndalimit, ndërsa në disa qendra të tjera gjendet jashtë dhomës së ndalimit. Në rastet kur tualetit gjendet jashtë dhomës së ndalimit zyrtari policor është i obliguar që të shoqëroj të ndaluarin gjë e cila shton rrezikun nga ndonjë incident i mundshëm. Veçantia për tualete që janë brenda dhomës së ndalimit, është se disa dhoma të ndalimit kanë të ngritur murin anësor që siguron ruajtjen e privatësisë, mirëpo, disa dhoma nuk e plotësojnë këtë standard. PSO-ja parashih që të ndaluarit t'i sigurohet privatësi gjatë përdorimit të tualetit. QN-të me tualete të vendosur brenda dhomës së ndalimit janë dymbëdhjetë (12), kurse jashtë dhomave të ndalimit tualetet i kanë të vendosura (3) qendra prej të cilave janë në: Vushtrri, Prizren dhe Hani i Elezit. Qendrat të cilat në dhomat e tyre kanë të ngritur murin anësor për ruajtjen e privatësisë së personit të ndaluar gjatë shfrytëzimit të tualetit janë shtatë (7)¹². Ato të cilat nuk kanë mur ndarës të tualetit janë qendrat në Dragash, Gllloboçicë, Vermicë, Qafë Morinë dhe Qafë Prush. Kapaciteti i këtyre dhomave në këto qendra të ndalimit edhe pse është vetëm për një person të ndaluar pozita e tualeteve në to është e atillë që nuk ofron privatësi për shkak se gjenden përballë derës së dhomës.

3.2.9 Funksionimi i qendrave të ndalimit në PK, rregullohet me PSO në të cilën parashihet që këto qendra të ofrojnë mundësinë e pastrimit¹³, ku të ndaluarit mund të pastrohen sipas nevojës. Mundësinë e bërjes së pastrimit (larjes) e ofron vetëm QN në Vushtrri. Marr parasysh këtë statistikë vlerësimi për këtë pikë është në nivelin dobët. Përgjegjësit e qendrave të ndalimit

¹⁰ PSO-Qendrat e ndalimit, nr. referues: DDO-04/022/2013, pika D-1.9

¹¹ Formularët e inspektimit dhe fotot nga këto qendra

¹² Tabela nr. 1

¹³ PSO për qendrat e ndalimit, pika D-1.9

kanë arsyetuar mungesën e mundësive për pastrim (larje) me hapësirë të kufizuar dhe kohës së shkurtër të qëndrimit të personave në këto qendra (jo me gjatë se 48 orë).

3.2.10 Niveli i pastërtisë është vlerësuar me anë të shikimit vizual të hapësirave, duke vlerësuar pastërtinë e çarçafëve, dyshemesë, mureve, dritareve, tualetit, mungesën e kundërmimit etj. Si kriteret të vlerësimit janë përdorur tri nivele matëse të higjienës: dobët, mirë dhe shumë mirë. Dobët janë vlerësuar rastet kur brenda dhomave batanijet, shtretërit, dritaret, muret, dyshemeja lavamanët e tualetet kanë qenë të papastra. Kurse me kriterin më të lartë të vlerësimit të higjienës “mirë” është vlerësuar në rastet kur në përgjithësi dhomat duke e përfshirë edhe hapësirën e qëndrimit të personelit të PK-së sipas pamjes vizuale kishin nivel të mirë të pastërtisë.

3.2.11 Inspektimi ka nxjerrë në pah se niveli i pastërtisë i vlerësuar me kriterin “shumë mirë” është hasur në katër (4) qendra të ndalimit: Prizren, Rahovec, Qafë Morinë dhe Qafë Prush. Ndërsa me kriterin “mirë” të vlerësimit janë gjetur shtatë (7) qendra të ndalimit: Mitrovicë Jugu, Pejë, Istog, Dragash, Malishevë, Leposaviq dhe Hani i Elezit, kurse, vlerësim i dobët i pastërtisë me kushte higjienike jo të kënaqshme është gjetur në katër (4) qendra: Vushtrri, Deçan, Gllboçicë dhe Vermicë.

3.2.12 Çështja e pastërtisë dhe higjienës në qendrat e ndalimit konsiston edhe me faktin se në shumicën e stacioneve policore në momentin e inspektimit kanë qenë të përfunduara kontratat e mirëmbajtjes së pastërtisë dhe nuk ka zyrtarë në kuadër të personelit të SP-ve, që kujdeset për mirëmbajtjen e hapësirave brenda këtyre qendrave. Menaxherët e stacioneve policore kanë pohuar se përfundimi i kontratave për mirëmbajtje është një shqetësim që ndikon direkt në performancën e mbikëqyrësve dhe personelit të PK-së që punojnë në qendrat e ndalimit dhe personave të ndaluar që mbahen përkohësisht në ato hapësira.

3.2.13 Çarçafët, mbulesat dhe batanijet pastrohen në dy mënyra: brenda stacionit policor, ose në qendrat e paraburgimit të cilat gjenden afër qendrave të ndalimit, siç është rasti në Prizren. Sa i përket dyshekëve ishin në gjendje të pastër, duke përjashtuar Deçanin dhe Vermicën. Kurse, në Leposaviq në momentin e inspektimit në qelinë nr. 4 mungonte një dyshek ndërsa në SPK Vermicë nuk janë gjetur çarçafët në shtretërit brenda dhomave të ndalimit.

3.2.14 Një ndër standardet e përcaktuara në PSO është vendosja e orendive për pushim¹⁴ (karrige ose ulëse të fiksuara) brenda dhomave të ndalimit, me qëllim që personat e ndaluar gjatë kohës së kufizimit të lirisë dhe qëndrimit në hapësirat qendrave të ndalimit të kenë mundësinë që të pushojnë, të lexojnë apo edhe të marrin ushqimin në to. Ky standard i paraparë është vlerësuar në kategorinë dobët, pasi që e gjetur në këtë pikë është se asnjë qendër e ndalimit nuk posedon karrige ose orendi të fiksuara për pushim brenda hapësirave të dhomave të ndalimit.

3.2.15 Pasi që të nxjerrët aktvendimi mbi ndalim, njëra prej masave të procedimit të personit të ndaluar është edhe kontrolli fizik i tij, me ç’rast të gjitha sendet e tij merren përkohësisht deri sa ai/ajo qëndron në hapësirat e qendrës së ndalimit. Për këto sende të marra, qendrat duhet të ofrojnë vend të sigurt për ruajtje e që sipas PSO-së është e paraparë që brenda qendrave të ketë sirtar me mundësi të mbylljes me qëllim të ruajtjes së sigurt të tyre¹⁵. Gjatë inspektimit kemi vërejt se nuk përdorën sirtarët të standardit të njëjtë, mirëpo, këta sirtarë të standardeve të

¹⁴ PSO për qendrat e ndalimit, pika D-1.5

¹⁵ PSO për qendrat e ndalimit, pika D-1.4

ndryshme ofrojnë siguri për ruajtjen e gjërave të konfiskuara. Të gjeturat tregojnë se katërmbëdhjetë (14) nga këto qendra posedojnë këta sirtarë të bllokuar për ruajtjen e gjërave të konfiskuara nga personat e ndaluar, kurse një (1) stacion, ai i Leposaviqit nuk e ka një sirtarë të tillë.

3.2.16 Sigurimi i ushqimit për personat e ndaluar edhe më tutje nuk është rregulluar në formë unike për të gjitha stacionet policore. Disa nga qendrat e ndalimit, ushqimin e sigurojnë nga kuzhina e qendrave të paraburgimit. Këtë formë të furnizimit me ushqim për të ndaluarit e kanë ato qendra të cilat ndodhen më afër qendrave të paraburgimit sikurse është Peja, Gjilani dhe Prizreni. Ndërsa, pjesa tjetër ushqimin për personat e ndaluar e sigurojnë përmes parave të gatshme si dhe në raste të tjera, PK kontraktin ndonjërin nga restorantet që shfaq interesim për kontratë për të ofruar ushqimin për personat e ndaluar. Vlen të ceket se kjo PSO nuk e ka rregulluar si duhet mënyrën e sigurimit të ushqimit dhe kontrollin e ushqimit i cili merret nga kontraktuesit për të ndaluarit, mirëpo, kjo PSO¹⁶ ka përcaktuar vetëm kohën dhe racionet që duhet dhënë personit të ndaluar për aq kohë sa ai qëndron aty.

3.2.17 Gjatë inspektimit të kushteve materiale për persona të ndaluar, IPK është fokusuar edhe në kushtet e punës për zyrtarët policorë që janë të caktuar të punojnë në qendrat e ndalimit, qendra këto të cilat në kohën e zhvillimit të inspektimit kanë qenë në funksion. Kushtet për kryerjen e detyrave policore janë vlerësuar të mira, mirëpo, çdoherë me tendencë të përmirësimit të tyre në të ardhmen, pasi që kjo ndikon direkt në përmirësimin e performancës dhe ngritjen e nivelit të përgjegjësisë tek zyrtarët policorë që punojnë aty.

3.2.18 E gjetur tjetër lidhur me zyrat e monitorimit është se nuk gjenden në nivel me hapësirën e qendrës së ndalimit p.sh. Rahovec ku qendra e ndalimit është në podrum kurse zyra e zyrtarit policor që mbikëqyr qendrën gjendet në katin e parë. Me këtë rast zvogëlohet efikasiteti i mbikëqyrjes së të ndaluarve dhe rritet niveli i rrezikshmërisë.

3.2.19 Procedura e trajtimit të personave të ndaluar në pikëkalimet kufitare dallon nga trajtimi në qendrat e ndalimit të DSP-ve. Nëse një person ndalohe në vendkalime kufitare si i dyshuar për ndonjë vepër penale i njëjti ndalohe përkohësisht brenda qendrës së ndalimit deri sa të kontaktohet njësia policore përkatëse e cila do të vazhdon më tutje të merret me rastin, varësisht nga natyra e veprës penale. Ndalimi i këtyre personave në asnjë rast nuk kalon më shumë se gjashtë (6) orë, në shumicën e rasteve sipas personave përgjegjës kjo kohë madje nuk kalon as 2-3 orë. Po ashtu të njëjtën procedurë të veprimit e ka edhe Stacioni Policor në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari”, me që rast ky stacion policor nuk ka qendër të ndalimit, mirëpo aty gjendet një hapësirë për qëndrim deri në paraqitjen e njësisë përkatëse për ta pranuar personin e dyshuar për vepër penale.

¹⁶ PSO për qendrat e ndalimit, pika D-2.20

Tabela nr. 1 Kushtet materiale në Qendrat e Ndalimit

Drejtoritë Rajonale të PK-së	Stacioni Policor	Numri i dhomave të ndalimit	Nr. i dhomave në funksion në Qendrat e Ndalimit	Kapaciteti (shtretër)	Sipërfaqja e dhomave të ndalimit / m ²	Sipërfaqja për person në dhomat e ndalimit m ²	Ndriçimi natyral			Ndriçimi artificial			Ventilimi		Tualeti			Pastërtia			Orendi të fiksuara për pushim		Sirtar i bllokuar për ruajtjen e gjërave të konfiskuara		Alarm për thirrje në rastet kur personat e ndaluar duan të kontaktojnë me zyrtarin policor mbikëqyrës		
							Dobët	Mirë	Shumë mirë	Po	Jo	Pjesërisht	Po	Jo	Brenda dhomës	Brenda dhomës me mure	Jashtë dhomës	Dobët	Mirë	Shumë mirë	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po
Mitrovicë Jug	Mitrovicë Jug	6	5	9	84.8	14.3			X			X			X		X			X	X			X			
	Vushtrri	3	3	3	27.1	9		X		X		X			X	X			X	X			X				
Pejë	Pejë	4	4	8	51.5	12.87		X		X			X		X		X		X	X				X			
	Deçan	2	2	4	27	13.5	X		X		X		X		X		X		X	X			X				
	Istog	4	4	6	40.5	10.12			X	X		X		X		X		X		X	X			X			
Prizren	Prizren	5	5	6	43	8.6		X	X		X			X		X	X		X	X			X				
	Dragash	2	2	2	20	10			X	X		X		X		X	X		X	X			X				
Gjakovë	Malishevë	5	5	8	63.8	12.76		X	X		X		X		X		X		X	X				X			
	Rahovec	4	3	8	63	15.75			X	X		X		X		X	X		X	X			X				
Mitrovicë Veri	Leposaviq	4	4	6	41.6	10.4		X		X		X		X		X		X		X		X					
Lindje	Hani i Elezit	1	1	1	3.2	3.2	X		X			X		X		X		X		X	X			X			
Lindje	Gllboçicë	1	1	1	8	8		X		X		X		X		X		X		X	X			X			
Perëndim	Vermicë	2	2	2	11.4	5.7			X	X		X		X		X		X		X	X			X			
Perëndim	Qafë Morinë	2	2	2	11.3	5.7			X	X		X		X		X		X		X	X		X				
Perëndim	Qafë Prushi	2	2	2	11.3	5.7			X	X		X		X		X		X		X	X			X			
GJITHËSEJ		47	45	68	507.5	145.6	2	6	7	14	/	1	13	2	5	7	3	4	7	4	/	15	14	1	1	11	3

3.3. Identifikimi dhe vlerësimi i aspektit të sigurisë në Qendrat e Ndalimit

3.3.1 PK-ja që prej themelimit rëndësi të veçantë i ka kushtuar ruajtjes dhe zbatimit të ligjit, mbrojtjes së lirisë dhe të drejtave themelore të njeriut që janë ndër elementet e domosdoshme për ruajtjen e sigurisë. Si institucion demokratik PK-ja në vazhdimësi ka dëshmuar që respekton integritetin fizik dhe mendor të qenieve njerëzore, duke qenë e vendosur në trajtimin e drejtë të personave të privuar nga liria, me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga aktet më të larta ndërkombëtare dhe ligjet pozitive në Kosovë.

3.3.2 Gjatë zhvillimit të inspektimit njëra ndër fushat që është trajtuar me rëndësi të posaçme është edhe vlerësimi i aspektit të sigurisë në qendrat e ndalimit që janë të vendosura në kuadër të Stacioneve Policore dhe Stacioneve Policore të Policisë Kufitare. Për të bërë vlerësimin e aspektit të sigurisë në këto qendra janë trajtuar këto çështje: kamerat, dritaret, dyert, dalja emergjente, plani i evakuimit, siguria brenda dhomës së ndalimit, aparati për fikjen e zjarrit etj. (Shih tabelën nr. 2)

3.3.3 Në kuadër të aspektit të sigurisë brenda qendrave të ndalimit, janë të vendosura kamera të sigurisë të cilat shërbejnë për të monitoruar të ndaluarin duke e pasur në vëzhgim gjatë gjithë kohës. Gjatë inspektimit është vërejtur se kamerat janë të vendosur në hapësirën e dritares së dhomave të ndalimit nga pjesa e korridorit, prapa grilave, kurse në disa raste ato janë të vendosura brenda dhomave të ndalimit. Gjatë momentit të inspektimit inspektorët policor kanë testuar të gjitha kamerat në këto qendra, mirëpo, është hasur që ato janë jashtë funksionit për arsye të ndryshme, si: dëmtimet nga faktori njeri, mbushja e kapacitetit të hard diskut dhe prishjet e tjera elektronike që mund të ndodhin.

3.3.4 Zyrtarët përgjegjës të qendrave të ndalimit gjatë intervistimit kanë shprehur brengën e tyre lidhur me rrezën e mbulimit të kamerave pasi që ajo është e limituar dhe nuk mund të mbulojë gjithë hapësirën. Kjo vjen edhe si shkak se kamerat në të gjitha qendrat e ndalimit ku ato janë të vendosura, janë të fiksuara dhe nuk ofrojnë mundësi manipulimi me to dhe në këto raste nga ana e zyrtarëve policor nuk mund të vëzhgohet personi i ndaluar në tërë hapësirën brenda dhomës në të cilën është vendosur dhe mbahet i ndaluar.

3.3.5 Gjatë inspektimit kemi gjetur se në pesëmbëdhjetë (15) qendra të inspektuara të cilat kanë qenë në funksion, në vetëm gjashtë (6) prej tyre sistemi i kamerave është funksionale, në dy (2) prej qendrave sistemi i kontrollit përmes kamerave ka qenë jashtë funksionit dhe në shtatë (7) qendra të ndalimit sistemi i kamerave nuk është i vendosur fare. Kamerat janë jofunksionale në qendrën e ndalimit në Leposaviq dhe Dragash. (Shih tabelën nr. 2).

3.3.6 Dyert e dhomave të ndalimit janë të ndërtuara nga materiali i fortë (metal) ku në pjesën e sipërme të derës është e vendosur një hapësirë ku i mundëson personit të ndaluar të komunikojë me zyrtarin policor që e ka nën-mbikëqyrje në rastet kur ata kanë nevojë të komunikojnë. Po ashtu, kjo hapësirë e lejuar e derës mundëson edhe ofrimin e ushqimit për personat e ndaluar. Kjo hapësirë në pjesën e sipërme të derës sipas nevojave ka mundësi të hapet dhe të mbyllet dhe në të njëjtën kohë ka të vendosur grilat nga ana e jashtme, që mënjanon rrezikun për ndonjë lëndim të mundshëm që mund të shkaktohet krahas zyrtarëve policor. Gjatë inspektimit nuk është vërejtur ndonjë rast i dyerve të dëmtuara apo jofunksionale brenda këtyre qendrave.

3.3.7 Dritaret e vendosura në qendrat e ndalimit janë vlerësuar të ofrojnë siguri të lartë për personat që mbahen brenda dhomave të ndalimit. Dimensionet e dritareve nuk janë standarde për arsye se dhomat e ndalimit janë të madhësisë së ndryshme. Pjesa përbërëse e dritares është grila e cila është e vendosur për të shtuar sigurinë, mirëpo në qendrën e ndalimit ne Istog grilat janë të vendosura shumë afër me dritaret, dhe në rrethana të tilla paraqitet rreziku që dritarja të thyhet nga ana e personave të ndaluar, me ç'rast mund të lëndojnë veten.

3.3.8 Ruajtja dhe sistemimi i dosjeve të personave të ndaluar është njëra prej çështjeve me rëndësi pasi që ato përmbajnë të dhënat me të cilat sigurohet se të ndaluarit i janë respektuar të drejtat që i takojnë me ligj. PSO-ja e cila rregullon funksionimin e qendrave të ndalimit, parasheh që dosjet origjinale të të ndaluarve të fotokopjohen dhe ruhen në një vend tjetër për shkak të sigurisë së tyre. Gjatë inspektimit në këto qendra të cilat kanë qenë në funksion, kemi konstatuar se vetëm qendrat në stacionet policore Mitrovicë Jugu, Prizren dhe Leposaviq nuk ruajnë kopje të dosjeve të të ndaluarve në një vend të dytë. Ndërsa, qendra tjera të inspektuara i ruajnë kopjet e dosjeve të personave të ndaluarve dhe njëkohësisht respektojnë nenin 1.4 të PSO-së për qendrat e ndalimit të vitit 2013¹⁷. Nga kjo kategori përjashtohen qendrat e ndalimit të cilat funksionojnë nëpër vendkalime kufitare meqenëse ato vetëm e ndalojnë personin deri sa njësitë përkatëse vijnë për ta marrë të ndaluarin.

3.3.9 Për shkak të mundësisë së ndodhjes së fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga faktori njeri mund të paraqitet nevoja për evakuim të personave të ndaluar, zyrtarët konform planit të veçantë për evakuim duhet të jenë të përgatitur të veprojnë. Inspektorët kanë inspektuar edhe çështjen e daljeve emergjente secilën qendër të ndalimit. Gjatë inspektimit fizik kemi konstatuar se nëntë (9) qendra të ndalimit kanë dalje emergjente, kurse gjashtë (6) prej tyre nuk kanë dalje emergjente. Qendrat të cilat kanë dalje emergjente janë: Mitrovicë Jugu, Istog, Prizren, Dragash, Malishevë, Rahovec, Leposaviq, Vermicë dhe Qafë Prush, kurse ato të cilat nuk kanë dalje të tillë janë: Vushtrri , Pejë, Deçan, Hani i Elezit, Gllloboçicë dhe Qafë Morinë.

3.3.10 Siguria e lavamanëve-kroit, pothuajse në të gjitha qendrat e ndalimit janë në nivelin e duhur dhe ofrojnë siguri dhe funksionalitet të plotë, mirëpo, në SPK Gllloboçicë, nuk qëndron një situatë e njëjtë, kroi nuk i plotëson standardet e duhura të sigurisë, ai nuk është i vendosur në mënyrë të sigurt dhe elementet (bateritë e ujit) në lavamanë po ashtu nuk ofrojnë sigurinë e duhur.

3.3.11 Sipas PSO-së, aparatet për fikjen e zjarrit janë të paraparë të vendosën në një vend të dukshëm, që të jetë e lehtë dhe e shpejtë qasja në rast të nevojës¹⁸. Ky aparat është me rëndësi për arsye se në rastet e paraqitjes së ndonjë zjarri të mundshëm, ndihmon që me shpejtësi të mundësohet fikja e zjarrit dhe evakuimi i personave të ndaluar, duke arritur të mënjanohet rrezikun për jetë. Nga pesëmbëdhjetë (15) qendra të ndalimit të inspektuara të cilat kanë qenë në funksion, trembëdhjetë (13) prej tyre kanë pas në afërsi ose brenda hapësirës së qendrës aparatit për fikjen e zjarrit kurse dy (2) prej pesëmbëdhjetë (15) qendrave tjera, aparati për fikjen e zjarrit nuk ka qenë i vendosur në vend të dukshëm (Deçan dhe SPK Gllloboçicë). Sa i përket afatit të përdorimit të tyre ka rezultuar që dy aparate për fikjen e zjarrit nuk ishin brenda kohës së paraparë për përdorim (Istog dhe Qafë Morinë). (shih tabelën nr. 2). Dy (2) prej

¹⁷ PSO për qendrat e ndalimit, pika D-1.4

¹⁸ PSO për qendrat e ndalimit, pika D-1.5

pesëmbëdhjetë (15) qendrave tjera, aparati për fikjen e zjarrit nuk ka qenë i vendosur në vend të dukshëm e kjo është gjetur në Deçan dhe SPK Gllloboçicë.

3.3.12 PSO-ja ka paraparë që qendrat e ndalimit duhet të posedojnë kutinë e ndihmës së parë me të gjitha pajisjet e nevojshme brenda saj¹⁹. Inspektimi ka vënë në pah se kutinë e ndihmës së parë e posedojnë dhjetë (10) qendra të ndalimit, kurse në pesë (5) prej pesëmbëdhjetë (15) qendrave në PK nuk është gjetur kutia e ndihmës së parë. (tabela nr. 2)

3.3.13 Në qendrat e ndalimit duhet t'i kushtohet rëndësi të veçantë nivelit të sigurisë, të cilit duhet t'i jepet prioritet planifikimit, zhvillimit dhe menaxhimit të situatave të ndryshme që mund të paraqitet në rrethana të ndryshme. Plani i evakuimit sipas PSO-së është e paraparë të hartohet në nivel të QN-së dhe i veçantë nga Plani i Evakuimit në nivel të Stacionit Policor, kjo për qëllim të gatishmërisë më të lartë të reagimit emergjent në rast të fatkeqësive të ndryshme. Inspektimi ka vënë në pah se pesëmbëdhjetë (15) qendra të ndalimit të inspektuara që kanë qenë në funksion e posedojnë Planin e Evakuimit të hartuar për QN, ku në mesin e tyre ka raste kur Plani i Evakuimit i Stacionit Policor inkorporon në vete edhe Planin e Evakuimit që i takon hapësirës së Qendrës së Ndalimit. Një (1) prej pesëmbëdhjetë (15) qendrave të ndalimit nuk e ka prezantuar një Plan të tillë siç është QN Deçan.

3.3.14 Siç kemi cek më lartë kur kemi folur për kushtet materiale nëpër Qendra të Ndalimit të pikëkalimeve kufitare ato shërbejnë vetëm për periudhën e caktuar kohore deri sa të arrij një njësi tjetër nga PK-ja, e cila vazhdon me procedimin e të ndaluarit. Ndalimi i personit nëpër këto Qendra të Mbjajtjes nuk zgjatë në asnjë rast më shumë se gjashtë (6) orë.

¹⁹ PSO për qendrat e ndalimit, pika D-1.5

Tabela nr. 2 Kushtet e sigurisë në Qendrat e Ndalimit

Drejtoritë Rajonale të PK-së	Stacioni Policor	Videokontrolli			Siguria e dritareve		Siguria e dyerve		Dalja emergjente		Plani i Evakuimit		Siguria brenda dhomës së ndalimit		Aparati për fikjen e zjarrit		Kutia e ndihmës së parë		Mbajtja e dosjeve sipas PSO-së		Libri për evidentimin e personave të ndaluar në Qendrat e Ndalimit	
		Po	Jo	Jofunksionale	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo
Mitrovicë Jug	Mitrovicë Jug	X			X		X		X		X		X		X		X		X	X		
	Vushtrri	X			X		X		X	X		X		X		X		X		X		
Pejë	Pejë	X			X		X		X	X		X		X		X		X		X		
	Deçan		X		X		X		X	X		X			X		X		X			X
	Istog	X			X		X		X	X		X		X		X		X		X		
Prizren	Prizren	X			X		X		X		X		X		X				X	X		
	Dragash			X	X		X		X		X		X		X		X	X		X		
Gjakovë	Malishevë	X			X		X		X		X		X		X		X		X		X	
	Rahovec		X		X		X		X		X		X		X		X		X		X	
Mitrovicë Veri	Leposaviq			X	X		X		X		X		X		X		X		X	X		
Lindje	Hani i Elezit		X		X		X		X	X		X		X		X		X		X	X	
Lindje	Gllloboçicë		X		X		X		X	X			X		X		X		X	X		
Perëndim	Vermicë		X		X		X		X	X		X		X		X		X				X
Perëndim	Qafë Morinë		X		X		X		X	X		X		X		X		X				X
Perëndim	Qafë Prushi		X		X		X		X	X		X		X		X		X				X
<i>Gjithsejtë</i>		6	7	2	15	/	15	/	9	6	15	/	14	1	13	2	10	5	10	5	11	4

3.4 Vlerësimi i implementimit të rekomandimeve të IPK-së lidhur me Qendrat e Ndalimit

3.4.1 Si rezultat i rekomandimeve të dala nga inspektimet e rregullta të kryera nga IPK-ja si dhe iniciativat e menaxhmentit të PK-së për t'i adresuar problemet me të cilat ballafaqohen qendrat e ndalimit, me qëllim të përmirësimit të kushteve materiale dhe ngritjes së nivelit të sigurisë PK-ja ka filluar procesin e renovimit në këto qendra. Prosesi i renovimit ka filluar në njëmbëdhjetë (11) qendra dhe ky përmirësim i gjendjes fizike të këtyre objekteve do të ndikojë për të mirë në mënyrën e kryerjes së detyrave nga personeli policor dhe kushteve në të cilat mbahen personat e ndaluar.

3.4.2 Nga inspektimet e mëhershme janë dhënë rekomandime lidhur me mungesën: e mureve ndarëse të tualeteve; pastërtisë; e funksionimit të kamerave; e sirtarëve për ruajtjen e gjërave me vlerë; e ruajtjes së një kopje të dosjeve në një vend të dytë si dhe planit të evakuimit në nivel të qendrave të ndalimit.

3.4.3 Të gjeturat tregojnë se rekomandimet që kanë implikime buxhetore janë implementuar pjesërisht: muret ndarëse të tualeteve brenda dhomave të ndalimit (Dragash, Glloboçicë, Vermicë, Qafë Morinë dhe Qafë Prush) nuk janë të ndërtuara; sistemi i kontrollit përmes kamerave po ashtu është realizuar pjesërisht për shkak se në disa qendra të ndalimit nuk ka sistem të monitorimit përmes tyre dhe në disa tjera kamerat janë jashtë funksionit²⁰; pajimi me sirtar me mundësi të mbylljes nuk është bërë në qendrën e ndalimit Lepasaviç.

3.4.4 Bazuar në të gjeturat e inspektimit të tanishëm del se rekomandimi i dhënë nga IPK për respektimin e PSO-së për ruajtjen e dosjeve të të ndaluarve në një vend të dytë akoma nuk është zbatuar plotësisht. Ndërsa, sa i përket planit të evakuimit ky rekomandim ka gjetur zbatim të plotë në të gjitha qendrat e ndalimit²¹.

²⁰ Tabela nr. 1 dhe 2

²¹ Tabela nr. 2

4. PËRFUNDIMET

4.1 Në kuptim të aspektit themelor të Mbrojtjes së të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Policia e Kosovës rëndësi të veçantë i ka kushtuar respektimit të integritetit fizik dhe mendorë të qenieve njerëzore e në rastin konkret personave të ndaluar. Për ti përmbushur dhe respektuar kërkesat e konventave të ndryshme ndërkombëtare dhe ligjeve të aplikueshme në vend lidhur me trajtimin e drejtë ndaj qasjes së personave të privuar nga liria, PK-së ka ndërtuar/hartuar dokumentin bazik PSO –të për Qendrat e Ndalimit DDO-04/022/2013, në të cilën ka përcaktuar rregullat dhe procedurat e punës policore ndaj personave ndaluar/arrestuar të cilët sjellin në qendrat e ndalimit si pasojë e dyshimit të bazuar për shkelje të dispozitave ligjore në fuqi.

4.2 PSO për QN-të është hartuar për të shërbyer si dokument referues për administrimin dhe procedurën e veprimit dhe e cila përmban kriteret të cilat shërbejnë në kryerjen e punëve, detyrave dhe përgjegjësi në këto qendrat nga zyrtarët policor. PSO-ja bazë referuese të ndërtimit të saj ka pas konventa të ndryshme ndërkombëtare si dhe ligje vendore që rregullojnë çështjet e personave që ndalohen si pasojë e dyshimit të bazuar për shkelje të dispozitave ligjore në fuqi e të cilët mbahen në qendrat e ndalimit. IPK pas identifikimit të kësaj PSO-je ka vlerësuar se në vijë të përgjithshme është theksuar që me dispozitat ligjore dhe aktet tjera normative vendore dhe ndërkombëtare janë të përcaktuara detyrat e zyrtarëve policor, por që shtrohet nevoja e përcaktimit më detaj të disa nga detyrave që i përkasin zyrtarëve policor në këto qendrat apo precizimi i dispozitave ligjore dhe akteve tjera normative ndërkombëtare dhe vendore që caktojnë detyrat dhe përgjegjësit e zyrtarëve policor në QN.

4.3 Nga pesëmbëdhjete (15) qendrat e ndalimit të cilat janë vlerësuar për përmbushjen e standardeve, inspektimi ka treguar se totali i hapësirave të dhomave nga matjet gjatë inspektimit është 507,5 m², gjë e cila përmbush kriterin e përcaktuar prej rreth 7 m² i cili kriter është i bazuar në raportin e Komitetit për Parandalimin e Torturës. Duhet theksuar se QN në SPK siç janë: Hani i Elezit, Vërmic, Qafë Morinë dhe Qafë Prushi nuk e plotësojnë kriterin prej rreth 7 m² por gjithnjë duke pasur parasysh që këto qendra nuk i mbajnë gjatë të ndaluarit aty ngase personat e tillë i dorëzojnë me procedurë të shpejtë në qendrat e ndalimit në Divizionin e Sigurisë Publike.

4.4 Sa i përket ndriçimit natyral në pesëmbëdhjete (15) qendra të ndalimit, IPK-ja ka përdorur tre kriteret matës nga të cilat shtatë (7) qendra kanë ndriçim natyral të mjaftueshëm dhe janë vlerësuar shumë mirë, gjashtë (6) mirë, dhe dy (2) nga to siç janë qendra në Deçan dhe SPK Hani Elezit me vlerësim të dobët. Mirëpo në përjashtim të Qendrës së Ndalimit në Mitrovicë Jugu tek i cili në momentin e inspektimit disa nga poqët elektrik nuk kanë funksionuar, të gjitha qendrat tjera kanë funksional ndriçimin artificial. Inspektimi ka vënë në pah se ventilimi në trembëdhjetë (13) QN është funksional deri sa jashtë funksionit është në QN Deçan dhe QNSPK Hani i Elezit. Ndërsa, në asnjë nga pesëmbëdhjete (15) qendrat e ndalimit të inspektuara nuk kanë qenë të vendosura karrige ose ulëset e fiksuara të cilat do të shërbenin si orëndi për pushim për personat e ndaluar. Sirtarë të mbyllur (bllokuar) për vendosjen e gjësendeve me vlerë të personave të ndaluar kanë katërmëdhjetë (14) QN, gjersa QN Leposaviq nuk posedon një lloj sirtari të tillë.

4.5 Qendra të ndalimit me tualetet të vendosura brenda tyre janë dymbëdhjetë (12), ndërsa tualetet jashtë dhomave të ndalimit i kanë tre (3) qendra: Vushtrri, Prizren dhe SPK Hani Elezit. Gjersa prej dymbëdhjetë (12) qendrave të ndalimit që kanë tualetet në dhoma shtatë (7) nga to janë të ndara me muri anësor përmes së cilit bëhet ruajtja e privatësisë së personit

të ndaluar. Si rezultat i skadimit të kontratave për mirëmbajtje të pastërtisë, në kushte jo të kënaqshme higjienike janë gjetur QN Vushtrri, QN Deçan, SPK Gllloboqicë dhe SPK Vermicë, gjersa në kushte të mira janë vlerësuar Mitrovicë Jugu, Pejë, Istog, Dragash, Malishevë, Leposaviq dhe Hani i Elezit kurse QN në: Prizren, Rahovec, SPK Qafë Morinë dhe SPK Qafë Prush është vlerësuar me kushte shumë të mira higjienike.

4.6 Inspektimi ka vënë në pah se nga pesëmbëdhjetë (15)qendra të cilat janë inspektuar në gjashtë (6) nga to është funksional sistemi i kamerave, dy (2) prej tyre nuk e kanë në funksion këtë sistem të kontrollit, deri sa në shtatë (7) nga to nuk kanë të vendosur fare sistemin e kamerave. Me nivel të sigurisë jo të kënaqshëm brenda dhomës është gjetur qendra e ndalimit në SPK Gllloboqicë e cila nuk e ka të vendosur në mënyrë të sigurt baterinë e ujit në lavaman. Disa QN e kanë të instaluar sistemin e thirrjes me anë të së cilit iu mundësohet të ndaluarit që të sinjalizojë zyrtarit policor për kërkesat ose nevojat e tij. E gjetur në këtë pikë është se vetëm në SPK Qafë Morinë është funksional ky sistem; ndërsa në Pejë, Malishevë dhe Qafë Prush ky sistem është jashtë funksionit, kurse, njëmbëdhjetë (11) qendra tjera të ndalimit nuk e kanë të inkuorporuar këtë sistem.

4.7 Nga pesëmbëdhjetë (15) qendra të ndalimit të inspektuara të cilat kanë qenë në funksion, trembëdhjetë (13) prej tyre kanë pas në afërsi ose brenda hapësirës së qendrës aparatit për fikjen e zjarrit kurse dy (2) prej pesëmbëdhjetë (15) qendrave tjera, aparati për fikjen e zjarrit nuk ka qenë i vendosur në vend të dukshëm. Sa i përket afatit të përdorimit të tyre ka rezultuar që dy aparate për fikjen e zjarrit nuk ishin brenda kohës së paraparë për përdorim.

4.8 Ruajtja dhe sistemi i dosjeve të personave të ndaluar në një vend të dytë bëhet në 7 QN të stacioneve policore, duke përjashtuar stacionet policore kufitare, deri sa një gjë e tillë nuk bëhet në qendren e ndalimit në stacionet policore Mitrovicë Jugu, Prizren dhe Leposaviq.

5. REKOMANDIMET

Në drejtim të përmirësimit të kushteve materiale dhe atyre të sigurisë në qendrat e ndalimit si dhe me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të performancës policore IPK nxjerrë për PK-në këto rekomandime:

1. *IPK-rekomandon Drejtorinë për Planifikim dhe Vlerësim Operacional që të angazhohet në drejtim të azhurnimit të PSO për Qendrat e Ndalimit, në mënyrë që të bëjë përcaktime më detaje rreth procedurave të pranimit dhe kontrollimit të personave të ndaluar, apo të jepen precizime të dispozitave ligjore dhe akteve tjera normative vendore dhe ndërkombëtare që parashohin detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve policor në Qendrat e Ndalimit.*
2. *IPK- rekomandon stacionin policor Mitrovicë Jugu të sigurohet që Qendra e Ndalimit çdo herë të ketë në funksion ndriçimin elektrik me qëllim që dhomat të kenë ndriçimin adekuat.*
3. *IPK-rekomandon menaxhmentin e lartë të SP Istog që të angazhohet në drejtim të evitimit të afërsisë së grilave të dritareve me xhamat e dritareve me qëllim të mënjanimin të mundësisë së thyerjes së xhamave nga ana e të ndaluarve.*
4. *IPK-rekomandon Departamentin për Shërbime Mbështetëse që të ndërmerr hapat e nevojshëm në drejtim të fillimit të procedurave kontraktuese me qëllim që të lidhen kontratat për mirëmbajtje të higjienës.*
5. *IPK-rekomandon intensifikim të bashkëpunimit në mes Departamentit për Shërbime Mbështetëse dhe menaxherëve të lartë përgjegjës për Qendrat e Ndalimit, që pajisjet të cilat janë identifikuar se nuk i kanë, apo janë jashtë funksionit si: ventilimi, karrige ose ulëse të fiksuara, sirtarët e mbyllur, të angazhohen në realizimin e përmbushjes së kriterëve të cilat janë të potencuara në PSO.*
6. *IPK-rekomandon intensifikim të bashkëpunimit në mes Departamentit për Shërbime Mbështetëse dhe menaxherëve të lartë përgjegjës për Qendrat e Ndalimit, që pajisjet të cilat janë identifikuar se nuk i kanë, apo janë jashtë funksionit si: video kamerat, aparati për fikjen e zjarrit, ndihma e parë, sistemi për thirrje të zyrtarëve policor nga ana e të ndaluarit, t'i vënë në funksion në afate sa më të shkurta kohore .*
7. *IPK-rekomandon të gjithë menaxherët e lartë përgjegjës të stacioneve policore që në të ardhmen dosjet e personave të ndaluar që nuk ruhen në një vend të dytë të respektojnë nenin 1.4 të PSO-së për ruajtjen e një kopjeje të dosjes në një vend të dytë.*

6. PLANI I VEPRIMIT I PK-së PËR PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE TË IPK-së

Nr	Rekomandimi	Komentet	Plani i veprimit
1	IPK-rekomandon Drejtorinë për Planifikim dhe Vlerësim Operacional që të angazhohet në drejtim të azhurnimit të PSO për Qendrat e Ndalimit, në mënyrë që të bëjë përcaktime më detaje rreth procedurave të pranimit dhe kontrollimit të personave të ndaluar, apo të jepen precizime të dispozitave ligjore dhe akteve tjera normative vendore dhe ndërkombëtare që parashohin detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve policor në Qendrat e Ndalimit.	DPVO është në përfundim të azhurnimit të PSO-së për Qendrat e Ndalimit duke pasur parasysh dhe me prioritet rekomandimet nga IPK-ja.	Hartimi përfundimtar i kësaj PSO-së për Qendrat e Ndalimit do të jetë me datë 27.12.2016 Po ashtu me qëllim të implementimit të rekomandimeve të IPK-se në gjitha qendrat e ndalimit do të jemi në kontakte të vazhdueshme zyrtare me Komandantët e Stacioneve Policore me qëllim të ngritjes së përgjegjësisë dhe profesionalizmit .
2	IPK- rekomandon stacionin policor Mitrovicë Jugu të sigurohet që Qendra e Ndalimit çdo herë të ketë në funksion ndriçimin elektrik me qëllim që dhomat të kenë ndriçimin adekuat.	DMO -ja pas takimit të dt. 18.11.2016 kur edhe ka pranuar rekomandimet nga ana e IPK-se ka filluar me sanimin dhe rregullimi e instalimeve elektrike me theks të veçant ndriçimi elektrike.	DMO Është filluar me dt. 23.11.2016 dhe do të funksionalizohen me 30.11.2016.
3	IPK-rekomandon menaxhmentin e lartë të SP Istog që të angazhohet në drejtim të evitimit të afërsisë së grilave të dritareve me xhamat e dritareve me qëllim të mënjanimin të mundësisë së thyerjes së xhamave nga ana e të ndaluarve.	DMO Përforcimi dhe funksionalizimi në ato qendra të ndalimit ku grillat kanë pësuar dëmtimet do të rregullohen brenda këtij viti.	DMO Matjet dhe inspektimet do të fillojnë nga 25.11.2016 dhe punedhe do të përfundojnë me 21.12.2016
4	IPK-rekomandon Departamentin për Shërbime Mbështetëse që të ndërmer hapat e nevojshëm në drejtim të fillimit të procedurave kontraktuese me qëllim që të lidhen kontratat për mirëmbajtje të higjienës.	Në gjitha Qendrat e ndalimit në Stacionet policore Kërkohet furnizim më i mirë me mjete për pastrim Si dhe me qëllim sa i përket mirëmbajtjes së higjienës në Qendrën e Mbajtjes janë marr masat shtes për ngritjen e nivelit të pastërtisë me rast janë siguruar mjete shtese për pastrim si dhe do të ketë kontrole më të shpeshta nga stafi menaxhues	Stafi menaxhues
5	IPK-rekomandon intensifikim të bashkëpunimit në mes Departamentit për Shërbime Mbështetëse dhe menaxherëve të lartë përgjegjës për Qendrat e Ndalimit, që pajisjet të cilat janë identifikuar se nuk i kanë, apo janë jashtë funksionit si: ventilimi, karrige ose ulëse të fiksuara, sirtarët e mbyllur, të angazhohen në realizimin e përbushjes së kriterëve të cilat janë të potencuara në PSO.	Qendrat e ndalimit , Gjakove Rahovec dhe Malisheve, Kamenice, Prizreni, Peja, Deçan,Viti janë identifikuar që kanë jashtë funksionit si: ventilimi, karrige ose ulëse të fiksuara, sirtarët e mbyllur, monitorimi me kamera alarm për thirrje të angazhohen në realizimin e përbushjes së kriterëve të cilat janë të potencuar në PSO. Pika kufitare Gllloboçicë, Hani Elezit Vetëm 5-6. m nga Dera e dhomës	DMO - ja ka planifikuar që përmes ngritjes së një tenderi për sanimin dhe renovim të pjesshëm të qendrave të ndalimit ti përfshije edhe pjesën e ventilimit pasi që janë në kompetenc të DMO-së. DMO Procedurat do të fillojnë nga 15.02.2017 Implementimi parashihen që të ndodhe rreth muajit 7 shtate 2017.

		gjendet dera emergjente e personelit. Dalje të veçantë nuk ka mundësi as hapësirë të rregullohet. Nga gjitha stacionet policore ku janë qendrat e ndalimit janë parashtruar kërkesa pranë DMO-se me qëllim që të intervenohet urgjentisht me qëllim që të sanohen këto probleme	
6	IPK-rekomandon intensifikim të bashkëpunimit në mes Departamentit për Shërbime Mbështetëse dhe menaxherëve të lartë përgjegjës për Qendrat e Ndalimit, që pajisjet të cilat janë identifikuar se nuk i kanë, apo janë jashtë funksionit si: ventilimi, ulëset e fiksuara, sirtarët e mbyllur, të angazhohen në realizimin e përmbushjes së kriteve të cilat janë të potencuara në PSO.	DMO – ja ka planifikuar që përmes ngritje së një tenderi për sanimin dhe renovim të pjesshëm të qendrave të ndalimit ti përfshije edhe sistemin e thirrjes përmes ziles pasi që janë në kompetence të DMO-se. DTIK Njësia e Kamerave në kuadër të DTIK është në proces të instalimit të sistemeve të reja të kamerave në Qendrat e Ndalimit në tërë Kosovën, mirëpo për shkak të buxhetit të kufizuar jemi duke bërë instalimet sipas prioriteteve. Qendrat e Ndalimit që deri më tash i kemi instaluar sistemin e ri të kamerave të sigurisë janë: SP Qendër, SP Ferizaj, SP Mitrovicë Jugu, SP Peje, SP Prizren, SP Gjilan dhe SP Malisheve, Glloboçicë, Hani Elezit	DMO Procedurat do të fillojnë nga 15.02.2017 Implementimi parashihet që të ndodh rreth muajit 7 shtatë 2017 . DTIK Në fazën e ardhshme që do të përfundoj më së largu me 15 Dhjetor 2016, do të kryhet edhe instalimi i sistemit të kamerave të sigurisë në këto Qendra te Ndalimit: SP Podujeve, SP Lipjan, SP Leposovic, SP Deçan, SP Suhareke, SP Rahovec . Në këto Qendra te Ndalimit kamerat do te vendosen brenda qelisë për të pasur pamje më të mire dhe pa pengesa nga grilat. Këto kamera janë të parapara të vendosen brenda qelisë për shkak se kamerat janë të kualitetit të lartë dhe janë Anti vandal (të qëndrueshme ndaj goditjeve). Kurse, në vitin tjetër do të vazhdojmë me instalime të tjera në Qendra të Ndalimit.
7	IPK-rekomandon të gjithë menaxherët e lartë përgjegjës të stacioneve policore që në të ardhmen dosjet e personave të ndaluar që nuk ruhen në një vend të dytë të respektojnë nenin 1.4 të PSO-së për ruajtjen e një kopjeje të dosjes në një vend të dytë.	Qendrat e ndalimit ne Prizreni, Peje, Istog, Viti, Dragash, Gjakove Malisheve, Rahovec, Mitrovicë Jugu, Veri, Vushtrri Rekomandimi është realizuar në pajtim me PSO-në përkatëse.	Shefi i sektorit të operatives, mbikëqyrësi i qendrës së ndalimit do jenë përgjegjës direkt së bashku me shefin e sektorit të resurseve për funksionalizim të këtij sistemi. Deri në funksionalizim janë udhëzuar zyrtarët policor në qendrën e ndalimit që të jenë vigjilent.